



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), dhe Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 3, pika 1.2, neni 5 pika 2 dhe 5, neni 7, neni 12 pika 2, dhe 13 pika 2, NP "Termokos" Sh.A në Prishtinë, me datë 13.03.2025 shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: Menaxher i Departamentit të financave - një (1) vend pune

Titulli i mbikëqyrësit: ZKFTH

Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar

Lartësia e pagës mujore: 1101.10 euro

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe menaxhon punët në Divizionin e financave;
- Mbikëqyr dhe aplikon të gjitha rregullat në lidhje me regjistrimet materiale-financiare të afarizmit të ndërmarrjes;
- Kujdeset për menaxhimin e pagesës për obligimin ndaj organeve qeveritare, llogarive të pagueshme, tatimeve, kontributeve dhe taksave të ndryshme, që janë të aplikuara me Rregulloret në fuqi, marrëveshje dhe kontrata të ndryshme;
- Kujdeset për dhënien e informatave zyrtarit për buxhet dhe raportim si dhe zyrtarit për planifikimin e humbjes dhe fitimit;
- Kujdeset për respektimin e afateve për dërgimin e pasqyrave financiare mujore, vjetore si në institucione qeveritare, mbikëqyrëse dhe për nevoja të ndërmarrjes;
- Inicon dhe verifikon barazimet me institucionet buxhetore dhe konsumatorët e sektorit të biznesit;
- Bën propozimin për rritjen e azhuritit në regjistrimet e dokumentacionit për t'i respektuar afatet;
- Ndhmon në përpilimin e procedurave të ndërmarrjes, që lidhen me Divizionin e kontabilitetit;
- Ndhmon të gjitha komisionet në barazimin e regjistrimit vjetor për të gjitha çështjet, të cilat ndërlidhen me divizionin e kontabilitetit;
- Kujdeset që informatat për përpilimin e raporteve dhe pasqyrave financiare nga ana e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit të jenë koherente, azhure dhe të sakta;
- Mbi punën e kryer raporton në baza ditore, javore dhe mujore;
- Bën vlerësimin periodik të performancës për divizionin e financave.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

- Bachelor/ Fakulteti Ekonomik;
- Minimumi 3-5 vite përvojë pune në menaxhim financiar, kontabilitet ose auditim;
- Të jetë kontabilist i certifikuar, nga një organ i licencuar nga KKRF-ja ose ndërkombëtar;
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar- (SNRF) në bazë të cilave raporton ndërmarrja;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike, posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit; përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit;
- Njohja dhe përdorimi i shkëlqyeshëm i programeve kompjuterike, MS Office;
- Aftësi organizimi, planifikimi, koordinimi;
- Të ketë aftësi të punojë nën presion, të ketë etikë të lartë dhe integritet të lartë pune;
- Të jetë në gjendje të punojë me orar fleksibil të punës;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze;
- Aftësi për analizimin dhe detektimin e çështjeve të rëndësishme financiare;
- Kapacitet për të trajnuar dhe zhvilluar stafin e financave;
- Zotësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara.

Aplikantët e interesuar për vendin e punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

1. Aplikacionin e plotësuar dhe nënshkruar;
2. CV e aplikantit;
3. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
4. Dëshminë mbi përvojën e punës përmes trustit dhe kontratave;
5. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Kopje të certifikatave, referencave tjera profesionale, që ndërlidhen me pozitën që aplikoni.

Mënyra e aplikimit: Kandidatët mund ta shkarkojnë aplikacionin për punësim, që gjendet në ueb faqen e NP "Termokos": www.termokos.org;

I tërë dokumentacioni duhet të skanohet dhe dorëzohet në formë elektronike. Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në mënyrë elektronike në emailin: burimet.njerezore@termokos.org. Pas dërgimit të email-it, ju do të pranoni konfirmimin nga ne. Nëse nuk keni pranuar konfirmimin, atëherë kontaktoni në nr. tel 038 541-780.

Konkursi i brendshëm do të jetë i hapur në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit në ueb faqe www.termokos.org.

Mbyllja e konkursit bëhet më datë: 28.03.2025, ora 24.00.

Vërejtje: Pranohet vetëm dokumentacioni i punonjësve të NP "Termokos" (sepse është konkurs i brendshëm).

Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Bazuar në UA 01/2024 nenin 13 pika 2 mënyra e vlerësimit bëhet si më poshtë:

1. Procedura e vlerësimit të konkursit të brendshëm përmban gjithësej 100 pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit;
2. Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë;
3. Intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

Kalendari i përafërt: Bazuar në UA 01/2024 nenin 7 pika 1.11, procedura e përafërt e rekrutimit do të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.